



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në
“Psikologji” me profile: a. Psikologji klinike, b. Psikologji
shkollore, c. Psikologji këshillimi, d. Psikologji organizacionale, e.
Menaxhim dhe vlerësim projektesh,
i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Aliriza Arënliu

2. Dr. Esmeralda Ismaili

Janar/2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Europian i Tiranës përbëhet nga 5 Fakultete, 11 Departamente dhe 4 qendra kërkimore. Njësia bazë që ofron programin e studimit është Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Njësia kryesore e mëparshme ka qenë "Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit", i cili është riorganizuar me urdhër të MASR Nr. 528, datë 04.09.2018 në "Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale".

Programi i studimit që vlerësohet në këtë raport është riorganizuar nga "Master i Shkencave" në "Psikologji", me profile: a. Psikologji Këshillimi. b. Psikologji Shkollore, licencuar me UMASH Nr. 452, datë 14.09.2011, në "Master i Shkencave" në "Psikologji" me profile: a. Psikologji klinike, b. Psikologji shkollore, c. Psikologji këshillimi, d. Psikologji organizacionale, e. Menaxhim dhe vlerësim projektsh, me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7 prot, datë 14.06.2018, dhe konfirmuar nga ana MASR me shkresën 8244/1, datë 04.09.2018 për ndryshimet në masën 20% në programin e studimit. Për vitin akademik 2018 - 2019, janë gjithsej 39 studentë, për të dy vitet.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi "Master i Shkencave" në "Psikologji", me profile: a. Psikologji Këshillimi. b. Psikologji Shkollore është akredituar për herë të parë në vitin 2013, me Urdhrin Nr. 54, datë 06.02.2013 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 423, datë 11.01.2013.

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Të realizohet përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore shkencore.
2. Të realizohet një studim i plotë i tregut të punës në terren për rëndësinë dhe zhvillimin e programeve të studimit në nivel Master i Shkencave.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në vend, sipas agjendës së përcaktuar, arrijmë në përfundimin se rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm për programin e studimit **janë përmbushur pjesërisht.**

Rekomandimi 1. Të realizohet përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore shkencore.


Nga konsultimi i dokumentacionit të dërguar si dhe nga vizitat në institucion, rezultojnë se janë bërë përpjekje për të përfshirë studentë në veprimtari kërkimore dhe shkencore, kryesisht nëpërmjet fitesës që pedagogët ju bëjnë për të qenë pjesë e projekteve të tyre individuale (Minutat e takimit), si dhe detyrimit të kryerjes së punimit të diplomës për t'u diplomuar. Po ashtu përmendet që studentët nxiten për të publikuar punimet e tyre në revistat shkencore të institucionit, ku ka një kontradiktë se në cilën revistë, Polis apo Educatio (Ref. RVB, fq. 11 dhe Dokumenti nr.18: Rekomandimet MSH-PSIKOLOGJI, pika II.a, 2) si dhe nuk ka evidencë për publikime në këto revista. Evidencë ekziston vetëm për një studim, realizuar në 2016, me temë: "Fenomeni i bullizmit në shkollat 9-vjeçare të Shqipërisë", që është një iniciativë e vlefshme.

Rekomandimi 1: Është përmbushur pjesërisht.

Rekomandimi 2. Të realizohet një studim i plotë i tregut të punës në terren për rëndësinë dhe zhvillimin e programeve të studimit në nivel Master i Shkencave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se departamenti realizon një analizë periodike të tregut të punës, në të cilën përfshihen nevojat e tregut të punës për profesionin e psikologut dhe mundësitë e punësimit në kontekstin kombëtar. Por, ky studim nuk rezultojnë të jetë konceptuar si një studim i mirëfilltë, duke përdorur instrumente studimi real dhe mbetet i pjesshëm duke qenë se nuk prezanton nevojat për secilin profil me të njëjtën peshë. Kjo gjë u konfirmua edhe në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, ku u konstatua vështirësia në aksesin për të matur realisht kërkesa e tregut. Megjithatë, institucioni ka gjetur forma alternative për të qenë në kontakt me kërkesat e tregut të punës, siç janë marrëdhëniet e konsoliduara me UET ALUMNI të punësuar, takimet dy herë në vit me Bordin e Tregut të Punës, organizimi i panairit të punës ku ftohen partnerë potencial për punësimin e studentëve, etj.

Rekomandimi 2: Është përmbushur pjesërisht



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Hartimi i raportit të Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile: a. Psikologji klinike, b. Psikologji shkollore, c. Psikologji këshillimi, d. Psikologji organizacionale, e. Menaxhim dhe vlerësim projektsh, u përpilua nga dy ekspertë me përvojë në fushën e mësimdhënies dhe profesionin e psikologjisë, Prof. Asoc. Dr. Aliriza Arënlju dhe Dr. Esmeralda Ismaili, si dhe me asistencën e përfaqësueses së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Emisa Isufaj. Ekspertët e përzgjedhur për t’u përfshirë në vlerësimin e këtij programi studimi janë miratuar nga ASCAL me anë të Urdhrit Nr. 83, datë 16.10.2019.

Grupi i ekspertëve të vlerësimit ka konsideruar të gjitha dokumentet e përfshira në DVV si dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitës në institucion për të përpiluar këtë raport vlerësimi. Po ashtu, grupi është konsultuar edhe me kuadrin ligjor, ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.


Gjithashtu, ekspertët kanë konsultuar me njëri-tjetrin të gjitha gjetet dhe konkluzionet që janë prezantuar në këtë raport, si dhe kanë dakordësuar bashkërisht për vlerësimin e standardeve. Me qëllim dhënien e një vlerësimi sa më objektiv për plotësimin e standardeve ka qenë një proces sa matematikor po aq dhe i bazuar në peshën që ka plotësimi i kriterit në garantimin e cilësisë për programin e studimit.

Më datë 08.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 9/1 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 14.01.2020, përmes sistemit AMS, dërgohet përgjigja e Institucionit në lidhje me draft - Raportin, “*Relacion lidhur me draft raportin e GVJ për programin MSh në Psikologji, me 5 profile*”.


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin të paraqitura sipas fushave, shprehet si vijon:

- Lidhur me komentin që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “*Të realizohet përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore shkencore*”, GVJ vlerëson përpjekjet e IAL por i mbetet konkluzionit të shprehur në dokumentin e draft raport RVJ, pasi nuk ka pasur evidenca për përfshirjen e tyre në revistat e përmendur.
- Lidhur me komentin që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “*Të realizohet një studim i plotë i tregut të punës në terren për rëndësinë dhe zhvillimin e programeve të studimit në nivel Master i Shkencave*”, GVJ vlerëson përpjekjet e IAL por i mbetet konkluzionit të shprehur në dokumentin e draft RVJ pasi evidenca e përfshirë në DVV si studim tregu nuk reflekton një metodologji të mirëfilltë studimi.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.1, Kriteri 5**, GVJ sqaron se specializime të tjera i referohen trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtjeshme të studentëve për të dalë në tregun e punës si profesionistë të profilit që ata kanë përzgjedhur. GVJ merr në konsideratë komentin e IAL dhe reflekton ndryshimin në kriteret e vlerësimit.

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 1**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 3**, GVJ merr në konsideratë komentin e IAL dhe reflekton ndryshimin në kriteret e vlerësimit, por duke përsëritur rekomandimin e rritjes së numrit të orëve apo lendëve që janë të përshtatshme për fushën e specializimit.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 6**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.1, Kriteri 5**, merr në konsideratë komentin e IAL dhe reflekton ndryshimin në kriteret e vlerësimit.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.2, Kriteri 3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.2, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.4, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.4, Kriteri 5**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.4, Kriteri 7**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.5, Kriteri 8**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.7, Kriteri 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ dhe sqaron se i referohet aktiviteti të realizuar në gjuhë të huaj në përgjigje të kërkesës së këtij kriteri.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.8, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.



- Lidhur me komentën që bëhet për vlerësimin e **Fushës V**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentën që bëhet për **Standardin VI.2, Kriteri 5**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ dhe argumenton me tej se ky kriter kërkon që në raport të përfshihen rezultate të tjerë (përpos atyre të dhëna nga studentët) si dhe masa për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.
- Lidhur me komentën që bëhet për vlerësimin e **Standardit VI.3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ duke argumentuar se komentet e mangësive apo çështjeve të paqarta janë shprehur për secilin koment.
- Lidhur me komentën që bëhet për **Standardin VI.5, Kriteri 1 dhe 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.



VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE “PSIKOLOGJI” ME PROFILE: A. PSIKOLOGJI KLINIKE, B.PSIKOLOGJI SHKOLLORE, C. PSIKOLOGJI KËSHILLIMI, D. PSIKOLOGJI ORGANIZACIONALE, E. MENAXHIM DHE VLERËSIM PROJEKTESH

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Vërtetohet se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, është i përshtatur me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e vlerave shqiptare. Ai është ndërtuar brenda kornizës ligjore për arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi mbështetet në misionin e UET, i cili është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare (<i>Statuti i UET</i>). Programi synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare, pasi i edukon dhe orienton studentët, krahas vlerave humane dhe me vlerat kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Vërtetohet se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, në UET është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë (sikurse parashikohet edhe në statutin e UET), duke diplomuar studentë që do të shërbejnë në shoqërinë shqiptare përmes dijes së marrë në procesin e mësimdhënies.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	GVJ nga takimet e realizuar gjatë vizitës konstatoi se programi i studimit është hartuar me qëllim diplomimin e studentëve të cilët përmes dijes së marrë do t’i shërbejnë nevojave dhe dinamikave të zhvillimit të tregut të punës. Programi i studimeve është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, që kërkon një orientim drejt shërbimeve psikologjike, sidomos në institucionet edukative, shëndetësore dhe projekte.
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, ka një kurrikul, e cila mundëson pajisjen e studentëve me njohuri të vlefshme dhe të nevojshme në fushën e psikologjisë. Megjithatë, kjo kurrikul lipset të përmirësohet më tej, veçanërisht në drejtim të kërkimit shkencor, që është domosdoshmëri për studimet e ciklit të tretë. Ashtu sikurse u pranua edhe në takimet e realizuara me grupin e përgatitjes së RVB dhe stafit akademik të përfshirë

	në këtë program, nevojiten specializime të tjera më të thelluara që studentët të jenë gati të ushtrojnë profesionin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Universiteti European i Tiranës ka hartuar dhe vendosur në zbatim Planin Strategjik 2015-2020. GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, është në përshtatje me strategjinë e institucionit, duke ju referuar objektivave të këtij programi në dokumentin e rregullores së programit.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Konstatohet se në dokumentet bazë të institucionit përcaktohen drejtimit prioritar akademike, të cila përthyhen edhe në këtë program studimi. Më konkretisht, prioriteti mbi kërkimin shkencor që është pjesë e dokumentit të Statutit, Rregullores dhe Planit Strategjik të Institucionit është në përputhje me objektivat strategjik për zhvillimin e “Masterit të Shkencave” në “Psikologji” me profile, ku synimi është formimi akademik, shkencor dhe bashkëkohor i studentit.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimi “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Konstatohet se struktura dhe organizimi i këtij programi studimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Konstatohet se programi është hartuar në përputhje me prioritetet e institucionit dhe në përshtatje me dinamikat dhe zhvillimet e tregut të punës. Interesat kombëtare garantohej nëpërmjet formimit të profesionistëve të cilët do të kujdesen për mirëqenien psikologjike dhe shëndetin mendor të qytetarëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar (specifikisht rregullorja e programit) si dhe gjatë takimeve të realizuar rezultojnë se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, ka objektiva të shprehur qartësisht, të cilat synojnë të përgatisin studentët me njohuri të thelluara teorike dhe kompetenca profesionale për të ushtruar profesionin e psikologut në një nga pesë profilet e ofruara. Por nga ana tjetër, GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve profilizuese të këtij programi konstaton se tre lëndët që diferencojnë profilet në kategorinë C nuk janë të mjaftueshme për të thelluar njohuritë e studentëve në profilin që ata do të përzgjedhin, por e lënë atë në nivelin e njohjes së profilit të zgjedhur.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezultojnë se ekziston një dokument mbi analizën e tregut të punës bazuar në nevojat e tregut për profesionin e psikologut dhe mundësitë e punësimit në kontekstin kombëtar. Por, ky studim rezultojnë të jetë empirik, më shumë sesa i ndërtuar mbi instrumente studimi real dhe mbetet i pjesshëm duke qenë se nuk prezanton nevojat për secilin profil me të njëjtën peshë. Megjithatë, IAL dhe njësi bazë që ofron këtë program studimi demonstroi përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me kërkesat e tregut të punës përmes marrëdhënieve të konsoliduara me UET ALUMNI të punësuar, me takimet dy herë në vit me Bordin e Tregut të Punës, me organizimin e panairit të punës ku ftohen partnerë potencial për punësimin e studentëve, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathëtisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni dhe njësi bazë janë të angazhuara seriozisht për të mundësuar që studentët e diplomuar të përshtaten në tregun e punës. Megjithatë, lipset që përmbajtja e programit të studimit të rishikohet me synim që studentët të pajisen me aftësi të thelluara njohurish dhe aftësi praktike, që i përgjigjen nevojave të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Në takimin me dekanen e fakulteti dhe drejtuesin e njësisë bazë u konfirmua se ndryshimet në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, me profile është formulë e përhapur dhe është aplikuar në të gjitha programet e studimit në rang institucioni. Përzgjedhja e profileve është bazuar kryesisht nga eksperiencia e stafit të seksionit të psikologjisë, ku u veçua eksperiencia nga Universiteti i Sheffield në Selanik, eksperiencia nga një universitet në Gjermani, si dhe eksperiencia e universiteteve italiane. GVJ shprehet se profilet e këtij programi studimi qëndrojnë si specialitete të veçanta me një kurrikul, e cila duhet të jetë më e thelluar në specialitetin përkatës.</p>

<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni bën përpjekje për të arritur dimensione ndërkombëtare përmes formave të mësimdhënies, metodave të vlerësimit, objektivave, përzgjedhjes së literaturës së huaj nga shtëpi botuese prestigjioze për fushën e psikologjisë, megjithatë programi i studimit mbetet brenda kufijve të arsimit universitar shqiptar, veçanërisht në konceptimin e syllabusit si dhe mungon një lidhje e qartë mes mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore shkencore të pedagogut.</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi synon dhe aftësimin profesional të studentëve. Për këtë arsye studentët e këtij programi në semestrin e dytë të vitit të dytë kanë të parashikuar si lëndë plotësuese “Praktikë dhe zhvillim karriere” dhe po ashtu njësia bazë ka parashikuar staf akademik, si përgjegjës për supervizimin e praktikave profesionale. Rekomandohet që praktika profesionale, vlerësuar me 10% të krediteve të totale të programit të studimit, të shtrihet në një vit akademik, duke i dhënë mundësi studentëve jo vetëm të informohen për profilin e tyre, por edhe të praktikojnë kompetenca që lidhen me to.</p>			
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Vërtetohet se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfshin të gjithë elementët e parashikuar në kornizën ligjore të arsimit të lartë në RSh. Konfirmohet nga takimet se institucioni dhe njësia bazë kanë burimet njerëzore për të ofruar programin në gjuhë të huaj, por në këtë program studimi nuk ka pasur raste të mobilitetit, ardhjes së studentëve të huaj për të zhvilluar studimet në një semestër në UET.</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe në takimin me grupin e punës, GVJ konstaton se institucioni ruan dhe arkivon dokumentet që lidhen me këtë program studimi si syllabuset, literaturën, shkresat, vendimet, etj., si dhe aktivitetet stafit akademik apo ato të realizuar me studentët. Këto dokumente mund të aksesohen edhe elektronikisht përmes sistemit të brendshëm të institucionit, intranet-it.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

<p>Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike</p>	<p>Konstatohet se institucioni ka eksperiencën e nevojshme, burimet njerëzore dhe kapacitetet fizike për të ofruar këtë program studimi.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
 Web site: www.ascal.al



për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni operon që prej 13 vitesh në fushën e arsimit të lartë dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, nga i cili ofrohet ky program, është themeluar në vitin akademik 2011-2012, kur u licencuan edhe programet e studimit në fushën e psikologjisë dhe edukimit. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, në vitin akademik 2019-2020 janë angazhuara 19 anëtarë si personel akademik, 14 PAE dhe 5 PAK.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Konstatohet përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Referoju kriterit të mësipërm (Kriteri 2). Gjithashtu, konstatohet se ky nuk është një program studimi ndërdisiplinor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i DVV dhe në takim me grupin e punës së RVB dhe drejtuesin e departamentit vërehet se institucioni ka procedura të qarta për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive. Më konkretisht, departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve është i ndarë në tre seksione: seksioni i psikologjisë, seksioni i mësuesisë dhe seksioni i sporteve. Mbarëvajtja e këtij programi studimi ndihmohet nga seksioni i psikologjisë. Kështu, drejtuesi i departamentit përcakton përgjegjësit e grupit mësimor/koordinatorit të programit, të cilët konsultohen së

	bashku me titullarët e lëndëve për të përmirësuar dhe përditësuar me literaturë të pesë viteve të fundit syllabuset e lëndëve.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar dokumenteve në DVV dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës, GVJ iu komunikua se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh homologe kombëtare dhe ndërkombëtare, ku numërohen në total 109 të tilla, nga të cilat 94 me universitete të huaja dhe 15 me universitete vendase, pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve janë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimeve. Këto marrëveshje nuk rezultojnë të jenë në terma specifik për t'i shërbyer realizimit të objektivave të procesit mësimor të këtij programi studimi.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Gjatë shqyrtimit të RVB por edhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë realizimin e praktikave profesionale. Megjithatë, rekomandojmë të shtohen marrëveshje me institucione të tjera (si p.sh., institute kërkimi), që do të ndihmojnë studentët e pesë profileve të këtij masteri të njihen dhe angazhohen në profilin e përzgjedhur.
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton se institucioni zotëron marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat përcaktohet se në cilat prej tyre mund të zhvillohen praktikat profesionale për studentët e këtij programi studimi. Në rastet që kontaktuam, disa nga studentët e kishin zgjidhur praktikën profesionale në mënyrë individuale.
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Konstatohet se institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara ka bërë të mundur shkëmbimin e stafit, për të dhënë mësim, në universitetet homologe dhe shkëmbimi i studentëve, nëpërmjet programit Erasmus+. Po ashtu, vërehen përpjekje të institucionit për t'u angazhuar në projekte europiane të arsimit të lartë. Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve mundëson koordinon aplikimet për grante kërkimore me partneritete strategjike.
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Nga shqyrtimi i DVV rezulton se departamenti përgatit një raport me statistika të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe një përmbledhje nga feedback që studentët kanë dhënë për eksperiencën e tyre në institucionin ku kanë zhvilluar praktikën. Në këtë program studimi për vitet akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 kanë qenë 3 studentë që kanë përfituar nga marrëveshjet e institucionit me programin e shkëmbimit Erasmus +, ndërsa nga marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucione të tjera kanë përfituar 2 studentë. Institucionet, ku kanë kryer praktikën pjesa tjetër e studentëve, janë siguruar nga vetë studentët ose me ndihmën e pedagogut udhëheqës të praktikës apo pedagogëve të tjerë të departamentit, të cilët kanë përdorur kontaktet e tyre personale. Rekomandojmë shtim të marrëveshjeve zyrtare të bashkëpunimit me institucione që përshtaten me profilin e diplomës së studentëve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Nga takimet me GVB, takimi me personelin akademik dhe shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se UET së fundmi ka krijuar në nivel institucioni një fond prej 75'000 euro, në formën e shpërblimit me synim nxitjen e stafin akademik për të botuar kërkimet shkencore cilësore në revista prestigjioze me faktor impakti. Për këtë program studimi asnjë prej personelit akademik nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi. Tjetër mundësi e prezantuar gjatë takimeve është edhe mundësia që institucioni u ofron stafit akademi për të publikuar në revistën shkencore POLIS apo për të referuar në konferencën vjetore ndërkombëtare "Ditët e Studimeve Shqiptare". Gjithashtu, GVJ ju komunikua se studentët e "Master i Shkencave" në "Psikologji" me profile, nxitën nga pedagogët e tyre të botojnë punimet e tyre në revistën shkencore "Polis", ose të referojnë në konferencën ndërkombëtare "Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)". Ndërkohë nga studentët e pranishëm në takim u konfirmua se ata nuk janë angazhuar në ndonjë kërkim shkencor gjatë periudhës së studimeve në këtë program, dy prej tyre pohuan se janë përfshirë si intervistues në një studim të ndërmarrë nga pedagogia e lëndës, gjatë ciklit të studimeve bachelor.
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ konstaton se institucioni në organikën e vet ka përcaktuar një pozicion, atë të Zv.Rektorit për kërkimin shkencor që kujdeset për ecurinë e kërkimit shkencor. Po ashtu, institucioni disponon një dokument për kërkimin shkencor me emërtimin Strategjia e kërkimit shkencor (2017-2020). Në këtë dokument detajohen objektivat dhe instrumentet që përdor institucioni për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Vërehet se institucioni ka krijuar hapësira për të promovuar rezultatet e kërkimit shkencor. Shtëpia Botuese UET Press, revistat shkencore, POLIS për shkencat humane vlerësohen si mundësi të mira në këtë drejtim.
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Institucioni dëshmon se ka në fokus mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe dekurajon plagjiaturën nga të gjithë palët, studentë apo staf akademik. Në dokumentin e Kodit të Etikës së institucionit dëshmohet një gjë e tillë.

<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Konstatohet përpjekje e institucionit për t'i dhënë hapësirë studentëve të ndërmarrin iniciativa në fushën e kërkimit shkencor, duke i mundësuar pjesëmarrje në konferencën shkencore të DSSH apo duke ju bashkuar pedagogëve të tyre në studimet që ata ndërmarrin. Në takimin me zv/ rektoren e kërkimit shkencor na u komunikua se këtë vit do të realizohet DSSH e dedikuar vetëm për studentët, ndërkohë që nga takimi me studentët e këtij programi studimi nuk u konfirmua pjesëmarrja e tyre në fushën e kërkimit shkencor. Rekomandohet një qasje pro aktive për nxitjen e studentëve të këtij programi studimi të ndërmarrin kërkime shkencore personale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Konfirmohet se programi i studimit MSh “Psikologji” me 5 profile është i organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Referuar kurrikulës së programit të studimit se rezulton se lëndët janë kategorizuar në katëgoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Vërehet se programi Master i shkencave në “Psikologji” ofron pesë profile, të cilat në vetvete përbëjnë specialitete në fushën e psikologjisë si psikologjia klinike, këshillimit, shkollore, organizacionale, ndërsa profili i menaxhimit të projekteve nuk është specialitet i psikologjisë.
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Në rregulloren e këtij programi studimi konstatohet se ky program synon të pajisë studentët me njohuri të nevojshme për të ushtruar profesionin e psikologut në drejtime të ndryshme. Megjithatë, GVJ rekomandon se kurrikula duhet rishikuar dhe përmirësuar me qëllim përmirësimin e këtyre objektivave. Disa lëndë si “Psikologjia e motivimit dhe emocionit” apo “Psikologji shëndeti” ofrojnë një hyrje në tematikat përkatëse dhe nuk mundësojnë përparimin dhe thellimin e njohurive.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se kurrikula e këtij programi studimi mundëson zhvillimin e njohurive dhe aftësive, por lipset që ajo të përmirësohet me tej për të mundësuar thellimin e tyre në profilin që studentët do të përzgjedhin.
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Vërtetohet se programi i MSh “Psikologji” me profile, përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale prej 2 vite akademike ose 4 semestra, ku në çdo semestër përfitohen 30 ECTS. Pas shlyerjes së detyrimeve, studenti pajiset me diplomë “Master i shkencave” në një nga 5 profilet e ofruara.
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar	Konstatohet se në kurrikulën e këtij programi studimi janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese sipas kategorive (A-E), me peshën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për

lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL.”). Kështu, në Kategorinë A janë përcaktuar 12 kredite ose 10% (referenca 5-10%), 60 kredite në kategorinë B janë parashikuar 60 ECTS ose 50% (referenca 50-60%), në kategorinë C janë parashikuar 18 kredite ose 15% (referenca 12-20%), në kategorinë D janë 12 ECTS ose 10% (referenca 10%), dhe në kategorinë E janë 18 kredite ose 15% (referenca 10-15%).			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në këtë program studimi punimi i diplomës konsiston në një studim shkencor me udhëheqje shkencore nga një pedagog. Për punimin e diplomës në kurrikul janë parashikuar 18 ECTS (15%).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Konstatohet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, që janë përgjegjëse për këtë program studimi zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të vlerësimit dhe akreditimit. Në DVV janë vendosur të gjithë aktet ligjore që vërtetojnë legjitimitetin e kësaj njësie për t’u nënshtruar procesit të vlerësimit dhe akreditimit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti është i përbërë nga 3 departamente dhe departamenti ka përgjegjësin, koordinatorin e grup lëndëve mësimore, stafin akademik, etj. Po ashtu edhe struktura akademike rezulton e përputhur me aktet ligjore dhe nënligjore, pra janë parashikuar data e fillimit, përfundimit të procesit mësimor, si dhe pushimet zyrtare.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Referuar RVB dhe dokumentacionit mbështetës Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përbëhet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit dhe në akademik 2018-2019 janë angazhuar 16 anëtarë efektivë nga të cilët 12 me grada e tituj; Departamenti i Arteve të Aplikuara, në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 9 anëtarë, prej të cilëve 7 me grada e tituj, si dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përgjegjës për këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12

	<p>anëtarë efektivë, nga të cilët 7 me grada e tituj (2 Prof. Dr., 3 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr. dhe 5 me MSc, të cilët janë në raportin PAE/PAK 12/9. Po ashtu, raporti personel akademik efektiv/studentë në nivel njësie bazë është brenda normës së përcaktuar në aktet nënligjore, më konkretisht me 1 me 28.</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shih komentet në kriterin 2.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe gjatë takimeve konstatohet se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka angazhuar personel akademik për realizimin e praktikës mësimore.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV konstatohet se dekan i njësisë kryesore, ku ofrohet ky program studimi ka nxjerrë një vendim (Vendim Nr.46, datë 11/11/2019), ku ka emëruar koordinatoren për seksionin e psikologjisë (ciklin e parë dhe të dytë të studimeve).</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>GVJ vërteton se në statutin e institucionit si dhe në dokumentin e organizmit dhe funksionimit të dekanatit dhe departamentit janë përcaktuar qartë detyrat e koordinatorit të programit. Koordinator i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek drejtuesi i departamentit ose gjatë mbledhjes së departamenti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit kanë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin, strukturën dhe kurrikulën e këtij programi.</p>



<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentet mbështetëse, GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese, sikurse janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Vërtetohet se programi i studimit MSh në “Psikologji” me profile, është i organizuar në lëndë që vlerësohen në kredite ECTS, të ndara në katër semestra, me nga 30 ECTS secili.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit MSh në “Psikologji” me profile, është i organizuar sipas një plani mësimor, në cilin specifikohen të gjitha lëndët, ndarjen e tyre në semestra, ECTS, orë në auditor, orë si punë të pavarur, seminare, leksione dhe projekte. Ndërsa në rregulloren e programit të studimit specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijes.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni zotëron dokumente të cilat përcaktojnë procedurat dhe kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve për studentët.</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve për këtë program studimi GVJ konstaton se ato përmbajnë informacion të detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si dhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ u komunikua se në çdo vit akademik departamenti bën rishikimin e syllabuseve me inputin e dhënë nga pedagogët e lëndës dhe anëtarët e bordit të tregut të punës. Më tej me mbështetjen e koordinators të programit të studimit, ndryshimet miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë. Mbetet paqartë sesi është procesi i konvertimit i konkluzioneve të dala nga konsultimi i syllabuseve të lëndëve me këtë bord.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



F-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Vërtetohet se ngarkesa e këtij programi studimi është strukturuar sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ashtu sikurse parashikohet për studimet master i shkencave, ky cikël realizohet në dy vite akademike, me kohë të plotë dhe në përfundim të tij studentët përfitojnë 120 ECTS.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se mënyra e organizimit të këtij programi studimi pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në orientimet që ato do të zgjedhin, megjithatë rekomandohet që këto njohuri të thellohen dhe t’i japin mundësi studentëve të vazhdojnë studimet e mëtejshme duhet të rishikohen dhe përmirësohen disa lëndë dhe syllabuse.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Konstatohet se organizimi i veprimtarisë mësimore, si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Rekomandohet që të shihet mundësia që lënda e Praktikës profesionale të shtrihet në dy semestra akademike, me qëllim ofrimin e mundësisë për të ushtruar aftësi profesionale apo kërkim shkencor.
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Konstatohet se struktura e programit, ngarkesa në kredite është në përputhje me Kartën e Bolonjës. Në planin mësimor janë parashikuar 300 orë (10%) nga të cilat 255 orë praktike janë në institucion dhe 45 janë parashikuar si punë e pavarur.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se 3 studentë nga ky program studimi kanë pasur mobilitet në program të ngjashëm ndërkombëtar, por nuk ka ndodhur e anasjelltas, pra nuk ka pasur mobilitet të studentëve të huaj. GVJ konstaton se mund të ketë vështirësi në transferimin e studimeve në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, për shkak të specifikës të këtij programi i cili është i profilizuar dhe jo me një drejtim specifik në fushën e psikologjisë.
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	GVJ iu komunikua nga disa burime se përditësimi i lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit është prioritet për institucionin. Konstatohet se në shumicën e syllabuseve është përfshirë literaturë e 5-7 viteve të fundit.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi konstatohet nevoja e rishikimit të disa prej tyre, me synim përshtatjen me objektivat e formimit të studentëve. Po ashtu edhe nevojitet të rishikohen edhe lëndët që profilizojnë studentët në një nga 5 profilet që ky program ofron.

Kriteri 8. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Si kurse shprehemi edhe në kriteret e mësipërme nevojitet që të rishikohet përbajtja e programit të studimit, për t'i dhënë mundësi studentëve të kenë një formim më të thelluar në profilet që ata do të përzgjedhin, por edhe një përshtatje më të mirë në tregun e punës.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konfirmon se gjatë takimeve dhe evidencave të vënë në dispozicion në DVV, institucioni konsultohet me bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës, për tu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Institucioni për këtë qëllim ka ngritur dhe një strukturë që është Bordi i Punës.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profile, ofron kombinim të veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor. Megjithatë, rekomandohet që të rishikohet edhe njëherë kurrikula me qëllim avancimin e njohurive që studentët do të përfitojnë nga ky program. Më konkretisht sugjerohet që syllabusi i lëndës "Metodat e kërkimit sasior" të rishikohet, për ta bërë më të përthyeshëm në kontekstin e psikologjisë dhe për t'i dhënë një peshë aftësimi për të dizenuar studime shkencore sasiore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Konstatohet se personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në "Psikologji" me profile, kanë formim akademik, pra gradat shkencore që parashikon legjislacioni në fuqi.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, si titullarë të lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj. Për vitin akademik 2018-2019, në programin e studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profile, janë angazhuar 5 pedagogë me titullin Prof. Dr.; 5 Prof. Asoc. Dr.; 9 Dr.

<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Konstatohet se përgjithësisht fusha akademike dhe kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit. Megjithatë ka disa përjashtime. Kështu nga shqyrtimi i CV-ve i personelit akademik se gjatë vitit akademik 2018-2019 u konstatua se 2 prej tyre nuk kanë formim të vazhdueshëm në psikologji. Dhe po ashtu në vitin akademik 2019-2020 janë dy anëtare D.Xh dhe B.H me specialitet në Punë Sociale dhe M.L pa specializim në disiplinën që ligjëron, por me fokus në edukim. Rekomandohet një vlerësim i kujdesshëm në këtë drejtim.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ iu komunikua se zhvillimi i praktikave mbeten një sfidë edhe për këtë program studimi, megjithatë institucioni bën përpjekje për të vendosur marrëdhënie bashkëpunime me institucionë të ndryshme që mundësojnë realizimin e tyre. Ashtu sikurse na u komunikua nga Zyra e Karrierës, kjo e fundit mbështet departamentet në përpjekjet e tyre për të lidhur këto marrëveshje. Departamenti kujdeset që të përzgjedh ekspertët sipas fushës së profileve për të referuar në auditor në kuadër të praktikave profesionale. Ndërsa për ndjekjen e këtyre praktikave përcaktohet një pedagog i departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Ky program studimi nuk parashikon orë laboratorike në kurrikul.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ iu komunikua se në procesin e përmirësimit të përmbytjes të programit të studimit, departamenti konsultohet me bashkëpunëtorë dhe partnerë të tregut të punës (referuar kryesisht Bordit të Tregut të Punës). Gjithashtu, gjatë takimeve u konfirmua se edhe ndarja e këtij programit në pesë profile ka ardhur si rezultat i input-it që kanë dhënë këta të fundit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit, GVJ iu konfirmua se departamenti organizon mbledhje periodike me studentët për të marrë</p>

edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	feedback-un e tyre për programin dhe për të ndërhyrë, po ashtu edhe studentët konfirmuan se konsultohen me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit. Kështu, një tjetër burim që kanë kontribuar në hapjen e profileve të reja në këtë program kanë qenë studentët.								
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Në takimin me përgjegjësen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit të Studentëve, GVJ iu konfirmua se institucioni i jep një vëmendje të veçantë ALUMNI. Kjo zyrë mban kontakte me studentët ALUMNI, merr informacion mbi karrierën e tyre, i fton ata në takime dhe konsultohet me ta, atë në masën më të madhe janë në përbërje të Bordit të Tregut të Punës.								
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Në takimin me drejtueset e njësisë kryesore/bazë, GVJ iu konfirmua se kanë marrëdhënie bashkëpunimi institucione të ndryshme që konsultohen për të bërë ndryshime/përmirësime të programeve të studimit. Në këtë program studimi u përmend marrëdhënia e bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut, ku kanë diskutuar për përshtatshmërinë e profileve të këtij programi dhe kuadrin ligjor të tij (referuar Minutave të Takimit të mbajtura nga përfaqësuesja e ASCAL). Edhe pse ka një kontratë zyrtare bashkëpunimi me UP, nuk ka Minuta Takimi për diskutimin e përshtatshmërisë së programit të studimit.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përbushet</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në dokumentin e rregullores së programit të studimit konstatohet se janë përcaktuar qartësisht prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor që janë në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Vërehet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve bashkërendojnë përpjekjet edhe me njësi të tjera të nxisin aktivitete të ndryshme. Në takimin me stafin akademik, GVJ iu komunikua se ata ndiejnë se kanë lirinë akademike të jenë pjesë e aktiviteteve shkencore dhe jo vetëm.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët	Konstatohet se programi i studimit ofron mundësi që studentët të angazhohen në studime dhe projekte kërkimore. Faktohet një studim ku janë përfshirë studentët, të udhëhequr nga një pedagogje.

të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Rekomandohet që departamenti dhe personeli akademik të përshtatë qasjen proaktive duke ndihmuar studentët e këtij programi të ideojnë studime në grup, edhe në kuadër të lëndëve mësimore, si p.sh., lëndët e kërkimit shkencor.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Dallohet qasja e institucionit për të qenë në linjë me politikat studimore kombëtare, shembull është edhe Programi i Madh Kërkimor (PMK) “Shqipëria Inovative”. Por, GVJ nuk konstaton ndonjë fokus specifik të programit të studimit në hartimin apo zbatimin e politikave studimore rajonale dhe kombëtare.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Konstatohet se njësia bazë që ofron këtë program studimi mbështetet financiarisht nga institucioni për të realizuar aktivitete kërkimore. Anëtarët e njësisë bazë inkurajohen të përfitojnë nga granti i dedikuar për publikimet e tyre në revista shkencore. Të ardhurat nga kërkimet shkencore nuk administrohen nga njësia bazë, ato administrohen në rang institucioni nga zyrat përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor për këtë program studimi, që prej akreditimit të fundit është ndërmarrë vetëm një studim. Rekomandojmë që të ndërmerren iniciativa të tjera për të realizuar objektivat e programit ku të përfshihen edhe profilet e tjera të tij.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ vëren se Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ka angazhuar personel akademik për të qenë pjesë e grupeve të PMK-ve. Në RVB përmenden dy studime të ndërmarrë nga personeli akademik si dhe një studim realizuar nga studentët me udhëheqjen e prej stafit akademik të këtij departamenti. Rekomandojmë përfshirje më të lartë studentëve në drejtimet e projekteve që institucioni promovon.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ konstaton se konferencat apo aktivitetet e tjera me natyrë shkencore organizohen në nivel institucioni, ku lihet hapësirë edhe stafin akademik dhe studentët e këtij programi, si në konferencat e DSSh apo edhe mundësia për të marrë pjesë në Projektin Kërkimor II: “Zhvillimi nëpërmjet edukimit”- Impakti i faktorëve psiko-social në zhvillimin/edukimin e individit. Mirëpo kjo e fundit nuk është

	përfshirëse për disa profile të tjera si atë klinik, këshillimit apo organizacional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni në raportin e vetëvlerësimit thekson se institucioni ka dokumente zyrtare që udhëzojnë stafin akademik për hartimin e sillabuseve, si të bëhet vlerësimi dhe për përdorimin e platformës LMS (Learning Management System). Përpos kësaj institucioni organizon trajnime për stafin akademik veçanërisht për stafin e ri akademik për përdorim të metodave të ndryshme në mësimdhënie. Si dëshmi për të dhënat e mësipërme është dorëzuar dokumenti që përcakton parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe një udhëzues të përgjithshëm për përdorimin e platformës LMS për mësimdhënësit. Në dokumente të tjera sa i përket faktit të organizimit të trajnimeve për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative vetëm dy aktivitete nga lista e aktiviteteve 2016- 2018 duken të jenë relevante me këtë kriter. Fakti tjetër që mund të lidhet me këtë kriter mund të jetë shkëmbimi i stafit me universitete në vende të tjera nga ku mund të bartin përvoja të reja.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Rregullorja e UET neni 22 përcakton përgjegjësitë dhe procedurat monitorimit. Në dokumentet përcjellëse janë bashkangjitur Formulari për vlerësimin e pedagogut, formulari i vlerësimit të pedagogut nga student dhe formulari për ankesa. Në shqyrtimin e dosjeve të pedagogëve është gjetur se formulari nga vlerësimi i eprorit ka qenë në dosjen e pedagogut. Mirëpo duhet të theksohet se komponenti i të qenit inovativ nuk përfshihet si pyetje apo kriter vlerësimi në formularët e vlerësimit.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Sipas raportit të vetëvlerësimit institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimet periodike të mësimdhënësve që ndodh në fund të çdo semestri. Më specifikisht studentët vlerësojnë pedagogët në fund të semestrit përmes platformës LMS. Vlerësimi ruan anonimitetin e studentëve. Në takim na është kumtuar që raporti i dorëzohet mbikëqyresit të pedagogut dhe vetë pedagogut.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve për punohen nga zyra KSBC apo IT dhe pastaj ju dërgohen udhëheqësve të departamentit dhe më pastaj e pedagogëve.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Raporti i vetëvlerësimit thekson se raportet e vetëvlerësimit të stafit dhe të dhënave të tjera përdoren për të identifikuar problemet dhe marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë. Theksohet se masat e marra kanë qenë organizimi i seminareve trajnuese për pedagogë dhe te masat konkrete për pedagogë që kanë treguar problematikë të vazhdueshme..

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, detyrat praktike, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Në shqyrtimin e sillbuseve për lëndë të caktuar metodat kryesore të mësimdhënies dhe nxënies janë: ligjëratat, prezantime nga studentët, lexim të literaturë që nuk është me vjetër se 5 vite, detyra semestrale, provime të ndërmjetme dhe finale. Në të gjitha lëndët janë përcaktuar se për çfarë njësi mësimore çka bëhet përfshirë metodologjinë dhe leximet që duhet të bëhen.	Dokumenti mbi parimet e ndërtimit të lëndës (Ref 39) përcakton format e zhvillimit mësimor gjegjësisht: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, detyrat praktike, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Në shqyrtimin e sillbuseve për lëndë të caktuar metodat kryesore të mësimdhënies dhe nxënies janë: ligjëratat, prezantime nga studentët, lexim të literaturë që nuk është me vjetër se 5 vite, detyra semestrale, provime të ndërmjetme dhe finale. Në të gjitha lëndët janë përcaktuar se për çfarë njësi mësimore çka bëhet përfshirë metodologjinë dhe leximet që duhet të bëhen.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Nëse analizohen sillbuset e programeve të gjitha kanë një format të vlerësimit. Përsëri nga sillbuset metodologjitë kryesore të përdorura janë ligjëratat klasike, lexime, prezantime nga studentët, studim rasti, detyra semestrale. Ndoshta vetëm një pikë e cila ka hapësirë për përmirësim mund të jetë çështja e punës praktike, gjë që u përmend edhe në takimin me studentët. Kërkesa ishte që institucioni të bëjë më shumë se që ka bërë deri tani në sigurim të vendeve për praktikë dhe të ofrojë mbikëqyrje për përvoja praktike.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Në bazë të raportit të vlerësimit të brendshëm UET organizon ditën e zhvillimit të stafit dhe trajnimin dy ditor “Back to Work Seminar”. Nga dokumentet e dorëzuara nuk mund të kuptohet se sa nga pedagogët nga programi ekzistues kanë marrë pjesë në këto trajnime apo aktivitete. Poashtu nuk është e qartë përmbajtja e trajnimit. Megjithatë shkëmbimi i stafit me universitetet perëndimore mund të jetë një mundësi e mirë për marrje të përvojave të shumëllojshme dhe implementimin e tyre në vend. Nga lista e projekteve të dorëzuar nuk mund të konstatohet se sa prej stafit ekzistues kanë përfutuar nga këto shkëmbime ndërkombëtare.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Në përgjithësi shqyrtimi i CV së stafit dhe lëndët që ligjërojnë tregojnë një përputhshmëri në mes prapavijës dhe lëndës. Përjashtim mund të jenë dy lëndë Metodën e kërkimeve sasimore dhe Metoda Kërkimi Avancuar. Në të parën rekomandimi do të ishte të jetë me prapavijë në studimet e fushës së psikologjisë dhe lënda më shumë të përmbajë

	tema të metodologjisë së hulumtimit në vend të statistikës. Në të dytën pasi nuk ka CV të stafit nuk mund të gjykoet përputhshmëria e prapavijës me lëndën.			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Studentët përdorin sistemin LMS për të vlerësuar mësimdhënësit në fund të çdo semestrit. Këto informata përfshirë informatat nga fokus grupet me studentët trajtohen nga udhëheqësit e departamenteve që përcjellin shqetësimet e ngritura me ndryshim te programit ose të personelit akademik.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Duke u bazuar në raportin e vetëvlerësimit, shqyrtimin e sillabuseve dhe bisedës me studentët, personeli akademik përdor metoda të shumëfishta të mësimdhënies përfshirë metoda vizuale, diskutim të rastit, prezantim nga studentët, puna në grupe.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Në shumicën dërmuese të lëndëve apo të sillabuseve të shqyrtuara lëndët përmbajnë aktivizimin e studentit në mësim përmes prezantimeve dhe në çdo vlerësim të lëndës 20% e lëndës vlerësohet nga detyra semestrale e studentit. Duke supozuar se në këto situata studentit pranon një fedback kjo mundëson zhvillimin e njohurive në lëndë dhe sensin e autonomisë në adresim, shtjellim të çështjeve relevante me lëndë të caktuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Sipas raportit të vetëvlerësimit në total UET ka në dispozicion 11.500m ² , 10 salla me 151 vende, 14 salla seminari me nga 35 karrige, 9 salla me 70 karrige. Kushtet në salla u konfirmuan edhe gjatë vizitës në ndërtesë. Sallat ishin të mirëmbajtura dhe me kushte të mira higjienike.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Gjatë vizitës në ndërtesë komisioni vlerësues vizitoi sallat ku mbahen ligjëratat e psikologjisë. Këto salla ishin të pajisura me pajisje themelore të mjaftueshme për mirëmbajtje të ligjëratave. Sallat ishin të pajisura me PC, projektorë, tabela.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Stafi akademik dhe studentët përpos metodave klasike të komunikimit përdorin sistem online të komunikimit duke përdorur sistemin LMS ku studentët pajisen me materialet e lëndës.

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Secili syllabus përmban për çdo orë mësimore materialet që duhet lexuar. Materialet vendosen në LMS nga pedagogu i lëndës. Materialet në bazë të një parimi të vendosur për të gjitha lëndët janë jo më të vjetra se 5 vite.</p>			
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka ka numër të limituar të librave specifikisht të ndërlidhur me psikologjinë.</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas të raportit të vetëvlerësimit studentët kanë qasje në platformat SAGE dhe EBSCO në të cilat universiteti është i abonuar të cilat mund të jenë më relevante për programet për të cilat institucioni vlerësohet.</p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në vizitë u identifikuan disa salla me PC të cilat mund të përdoren nga studentët për detyrat e tyre.</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UET ka sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek.; të shikojë notat dhe pikët <i>on-line</i> nga kudo që ndodhen.</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Siç është cekur në kriterin 8 sistemi LMS sistemin bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek; të shikojë notat dhe pikët <i>on-line</i> nga kudo që ndodhet. Po ashtu personeli akademik dhe administrative përdor intranetin për informimin në lidhje me zhvillimet akademike dhe procesin legjislativ.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik përmes orëve seminarike ndihmojnë studentët në strukturimin e temës së diplomës. Një nga dokumentet e dorëzuar jep udhëzime eksplicite për atë se si punohet dhe strukturohet tema e diplomës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.4

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



F-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Universiteti ka të rregulluar në statutin e saj që quhet Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësim të nevojshme. Kjo zyrë ka një plan të veprimit për vitin 2018 dhe 2019.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit. Departamenti përzgjedh stafin, shpërndan orët sipas kriterëve të caktuar. Drejtuesi i departamentit miraton sillabusët dhe bën vlerësimin e stafit. Stafi akademik është i vetëdijshëm që ata do të vlerësohen në fund të semestrit nga studentët për performancën e tyre në lëndët përkatëse.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Në përgjithësi strukturimi i lëndëve është uniform në aspektin e vlerësimit dhe mbajtjes së orëve. Nuk ka ndonjë lëndë specifike që inkurajon shembull intervenime apo implementim të projekteve në terren që do të mund të konsideroheshin si eksperimentale. Vlen të theksohet se nuk ka asnjë pengesë që mësimdhënësit të eksperimentojnë dhe zhvillojnë metoda të reja inovative të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nuk ka ndonjë sistem të caktuar të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. <i>Qendra e Metodologjisë dhe Kërkimit</i> ofron trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe: (1) Trajnimet për Doktorantë; (2) Trajnimet për Junior Researchers; (3) Trajnimet për Senior Researchers; (4) Trajnimet Metodologjike. Nuk është e qartë se sa nga stafit ekzistues kanë marrë pjesë në këto trajnime. Aktivitetet e tjera të përmendura në raportin e vlerësimit të brendshëm jo domosdoshmërisht lidhen me kriterin numër 4.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Programi Erasmus i përmendur nuk duket se ka të bëjë me programin që vlerësohet. Përmenden trajnime të herëpashershme por nuk është se ka dokumentin se cilat kanë qenë këto trajnime.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Në raportin e vlerësimit theksohet se zbatimi i metodave të reja varet nga vetë mësimdhënësit dhe se këto më lehtë zbatohen nga mësimdhënësit e rinjë e më pak nga ata me përvojë.

<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nuk ka ndonjë raport specifik apo dokument që tregon testimin e metodave të reja në mësimdhënie. Stafit në përgjithësi inkurajohet të zbatojë metoda të reja.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Vetëm dy aktivitete përmenden si rezultat i bashkëpunimit dhe përfshirjes së partnerëve, ato janë: “How to publish and research (29.06.2017); Si të jemi lektorë të suksesshëm (29.01.2016). UET mund të shtojë ende aktivitete në këtë drejtim të cilat mund të jenë të rregullta dhe obligative për stafin akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret e vlerësimit përcaktohen në syllabus të çdo lëndë të caktuar. Vlerësimi dhe rregullat e vlerësimit përmenden në Rregulloren e programit të studimit (Ref. Nr. 7) dhe Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1) Rregullorja e UET, Neni 24 (Ref.Nr. 5)</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët përmes syllabuseve nën një seksion të veçantë “Kontroll i Vazhdueshëm” njoftohen për mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Të gjitha syllabuset përcaktojnë një formë të vlerësimit për të gjitha lëndët: 10% niveli i diskutimit në seminare, 30% provimi i ndërmjetëm, 20% detyrë kursi dhe 40% provimi përfundimtar. Kjo në një mënyrë kufizon eventualisht metodat të tjera të vlerësimit.</p>			
	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
--	--	--	--	----------

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Pikët 100% rezulton nga mbledhje e totalit të vlerësimeve gjatë tërë semestrit, gjegjësisht: 10% niveli i diskutimit në seminare, 30% provimi i ndërmjetëm, 20% detyrë kursi dhe 40% provimi përfundimtar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sipas raportit të vetëvlerësimit vetëm në një lëndë “ <i>Psikopatologjia e moshës së hershme dhe adoleshencës</i> ” është zbatuar sistemi elektronik i vlerësimit. Lëndët e tjera me gjasë vlerësimet bëhen në formë klasike.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Për lëndë përkatëse studentët vlerësohen nga pedagogu i lëndës. Komisionet caktohen vetëm për tema të diplomave dhe në raste kur studenti ka shikim të kufizuar.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	GVJ konstaton se provimet janë të anonimizuara, pas kontrollimit pedagogu i dorëzon në sekretarinë mësimore. Nuk përmenden kamerat e sigurisë gjatë provimeve por në raport ceket se në provim përpos pedagogut të lëndës mund të jenë prezent edhe monitorues të tjerë të caktuar nga departamenti.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Raport vlerësues cek se detyrat e kursit janë ato që shoqërohen me komente dhe feedback. Studentët mund të caktojnë takime sqaruese me pedagogët për punime dhe detyra semestrale. Edhe gjatë bisedës me student studentët kanë konfirmuar komunikimin e hapur dhe fidebkun nga pedagogët.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Masat e marra dhe të përmendura vlerësohen të jenë të mjaftueshme për parandalim të kopjimit dhe plagjiaturës e që janë: prezenca e dy apo më shumë pedagogëve gjatë provimit, studentët i lejnë të gjitha materialet që mund të shërbejnë si burim informate për provim në një vend të caktuar, celularët kërkohen të mbyllen dhe të mos përdoren. Plagjiatura ndëshkohet me rregulloret e institucionit dhe që nga 2015 universiteti përdor programin softverik për antiplagjiaturë.



Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se ka periudha të caktuara deri kur duhet të kumtohen rezultatet e provimit. Provimet pasi të dorëzohen në sekretari ato nuk mund të ndryshohen nga pedagogu.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pedagogët brenda dy javëve organizojnë takim me studentë për të sqaruar pyetjet eventuale që ndërlidhen me vlerësimin. Pas përfundimit të konsultimit pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin e provimeve të shqyrtuara.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	GVJ konstaton se ka mekanizma të tjerë të ankimimit edhe pas konsultimit për vlerësim me pedagogun. Në rast të ndonjë pakënaqësie studenti e njofton udhëheqësin e departamentit, i cili ngre një komision për shqyrtimin e rastit. Këto procedura janë të përcaktuara në Rregulloren mësimore e Programit të Studimit, pika 5.8 (Ref.Nr.7).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi pretendon se me 5 profile mundëson thellimin e njohurive të studentëve në fushë të caktuar të psikologjisë. Në përgjithësi ekipi vlerësuar ka një dozë të skepticizmit se sa mund të thellohen njohuritë vetëm me disa lëndë zgjedhore.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).	Programi ka lëndë që fokusohen në kërkime shkencore, në lëndë që janë në fushën e psikologjisë, në lëndë më specifike apo të profilit, praktikë profesionale dhe punimi i diplomës. Nuk ka ndonjë aktivitet specifik që lidhet me zhvillimin e gjuhëve të huaja.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Nuk ka ndonjë mekanizëm specifik të studimit ose kompetencave përpos provimeve dhe detyrave të kursit si indikatorë të arritjes së kompetencave apo aftësive të studentit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Pedagogët në fund të lëndës i orientojnë për provimin përfundimtar dhe është në dispozicion për konsultë edhe para provimit.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Përkundër aktiviteteve të shumta me ligjërata publike, nuk janë vërejtur seminare të hapura për profilin e programit për të cilën bëhet vlerësimi.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në raportin e vlerësimit dhe në analizën e disa syllabuseve analiza e rastit dhe praktika mund të konsiderohen si komponentë që mund të zhvillojnë kompetenca praktike që mund të përdoren apo transferohen në punën e tyre në të ardhmen. Praktikrat profesionale janë përmendur nga studentët si një pikë që mund të përmirësohet nga UET për të krijuar më shumë mundësi dhe marrëveshje me institucione relevante për praktikë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Detyrat në grup janë njëra nga metodat e përmendura të cilat përforcojnë punën në grup dhe analiza e rasteve. Nuk ka ndonjë metodë tjetër që është përmendur që mund të rrisë shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	GVJ nga biseda me studentë konstaton se mjediset mësimore janë inkurajues për shprehjen e ideve dhe komunikimit të lirë me pedagogë. Temat e diplomës mbesin opsion më real ku eventualisht studentët mund të realizojnë ide më inovative.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nuk ka ndonjë mekanizëm specifik të përmendur për nxitjen e ideve inovative apo financim të tyre.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	GVJ vlerëson se programet e Erasmus + mundësojnë rritjen e shkëmbimit akademik për studentë. Në dokumentet e dorëzuar nga institucioni vërtetohet se disa studentë nga programi i vlerësuar kanë përfutuar nga grante të mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konsideron se programi i vlerësuar ka procedura të qarta dhe të përshkruara mirë për procedurat për provimin final dhe të diplomës dhe dokumentet janë publike më saktësisht Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10) përcakton përgjegjësitë e personelit akademik në procesin e diplomimit dhe sipas

informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	vlerësimit të brendshëm ky dokument dhe informatat ju jepen studentit para aplikimit për punim diplome.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Raporti i vetëvlerësimi duke u bazuar Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10) konsideron se nuk ka nevojë për provim final për testim të njohurive dhe vlerësimi final në programin e vlerësuar bëhet përmes punimit të temës së diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Përgjegjësitë e stafit akademik janë të përcaktuara me Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10). Institucioni apo programet specifike nuk kanë fushë specifike të studimit në të cilin fokusohet qoftë stafi akademik apo programi. Përcaktimi në një fushë të caktuar do të mund të krijonte mundësi për grumbullim të dhënave me pjesëmarrjen e studentëve në projekte më madhore të departamentit. Krijimi i fushave specifike të studimit nga personeli apo stafi akademik do të mundësonte krijimin e një sinergjie me punimet e studentëve që do të kontribuonin në një qëllim më të madh. Kjo qasje duket të jetë e duhur për kontekstet ku ka fonde të pakta për financim të studimeve apo intervenimeve psikologjike.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ndihmon studentët me vërtetime specifike që lëshohen me kërkesë të studentit, këto vërtetime mundësojnë qasjen e studentit në institucionet tjera për të grumbulluar të dhëna.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.5.2. dhe B.II.8.8 (Ref. Nr. 10) përcakton këto hapa dhe përgjegjësi të udhëheqësit të diplomës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përcaktimin shkencor të objektit të studimit; 2. Diskutimin e dobisë së punimit; 3. Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; 4. Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; 5. Ndërtimin e strukturës së punimit; 6. Përcaktimin dhe shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi; 7. Hartimin e punimit të diplomës; 8. Debatimin e përfundimeve të studimit etj. <p>Udhëheqësi është garantues i cilësinë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studentit, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës</p>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Çdo student në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë të përcaktuara në Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.5.2. dhe B.II.8.8 (Ref. Nr. 10).

<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët më përfundim të studimeve pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës së bashku me certifikatën e notave brenda 6 muajve pas datës së diplomimit. Konstatohet se suplementi i diplomës për studentët e këtij programi nuk përmban specifikimet sipas profileve përkatëse. Sugjerohet që të përmirësohet përmbajtja e suplementit ku të specifikohen profilet përkatëse të këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentit nuk i ofrohet kopje e plotë e programit, por studentit bën kërkesë për të marrë kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit konstatohet se dokumentacioni i studentëve pas përfundimit të studimeve ruhen kopjet e dokumentacionit të cilat arkivohen dhe ruhen për një periudhë të pacaktuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjitha dosjet e personelit akademik si atij efektiv dhe atij me kontratë që janë të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor - shkencor dhe administrativ. Kjo zyrë është përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e Dosjeve Individuale të personelit akademik. Gjatë takimit me përgjegjësen e kësaj zyre, GVJ shqyrtoi dosjet e dy anëtarëve të personelit akademik, F.Sh anëtare PAK dhe B.Sh anëtare PAE dhe konstatoi prezencën e të gjithë elementëve të përcaktuara në dokumentin e Rregullores së Burimeve Njerëzore.			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit.	Sipas të dhënave të siguruar nga DVV, takimeve me GVB, personelin akademik dhe përgjegjësen e zyrës së burimeve njerëzore rezulton se institucioni ndjek procedura transparente dhe ligjore për të rekrutuar personelin akademik. Procedurat janë qartësisht të shprehura në dokumentin e Rregullores së Burimeve Njerëzore.			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatorë dhe i bën ato publike.	GVJ konfirmon se institucioni ka procedura të përcaktuar për kriteret e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Në DVV, dokumentacionin mbështetës si dhe në takimet me GVB, personelin akademik dhe përgjegjësen e ZBNj rezulton se IAL ka përcaktuar procedura për rekrutimin e personelit akademik dhe ka një përputhje të personelit të rekrutuar me programin e studimit, me përjashtim të tre rasteve: personeli akademik efektiv B.H, e cila nuk ka edukim të vazhduar në psikologji, por disponon formim akademik dhe eksperiencë në një disiplinë tjetër (punë sociale), personeli akademik efektiv D.Xh, e cila është e angazhuar në mësimdhënien e një moduli specifik të këtij programi (Bazat e Psikoterapisë) ka formim në punë sociale në ciklin e parë, në ciklin e dytë studime evropiane dhe ciklin e tretë në punë sociale ose rasti i personelit PAK M.L e cila nuk ka formim në psikologji dhe kualifikimin e duhur për të dhënë një modul specifik në psikologjinë e këshillimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficientë dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Vërehet se institucioni disponon kapacitetet e nevojshme infrastrukturore për të mundësuar që personeli të kryej në komoditet detyrat e caktuara. Institucioni ka parashikuar salla për departamentet, zyrat dyshe, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme si: kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi.			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni tregon përpjekje në drejtim të mundësi të ofruar që stafi akademik të inkurajohet për kualifikim të vazhdueshëm, mundësi të tilla si: zhvillimi i konferencave shkencore vjetore (DSSH), fondi prej 75'000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara, përfshirja në PMK, si dhe mundësia për mobilitet akademik përmes programit ERASMUS +. Konstatohet një përfshirje e ulët e personelit akademik të këtij programi në mundësitë (përmendur mësipërm) për kualifikime të mëtejshme të ofruara nga institucioni.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Sikurse shprehet edhe në RVB dhe po ashtu në takimin me zv rektoren e kërkimit shkencor vërehet se institucioni përmes Qendrës së Metodologjisë dhe Kërkimit ofron trajnime për stafin akademik sesi të bëjnë punë kërkimore të cilat përmbushin kriteret për publikime në revista me faktor impakti. Ndërkohë që në drejtim të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, institucioni ka krijuar sistemin LMS që mundëson studentët dhe pedagogët të komunikojnë dhe shkëmbejnë informacione.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	GVJ konstaton se burimet njerëzore të angazhuara në këtë program studimi janë optimale për të përmbushur objektivat e tij, me gjithë këtë ngelet për t'u përmirësuar shpërndarja e lëndëve në bazë të profilit të personelit akademik të angazhuar dhe specifikes së modulit që jepet prej tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të	GVJ konstaton se mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e

numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike për këtë program studimi.			
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion, u vizituan ambientit ku zhvillohej mësimi për studentët e këtij programi dhe konstatohet se mjediset mësimore janë të përshtatshme për të zhvilluar mësim. Ambientet rezultojnë të kishin infrastrukturën e nevojshme teknologjike për të realizuar procesin mësimor si p.sh., PC, projektorë, foni dhe WI-FI.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për realizimin e procesit mësimor në këtë program studimi nuk nevojiten laboratorë apo aparatura të veçanta. Vërehet se sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Vërehet se institucioni ka laboratorë të cilët mund të përdoren edhe për këtë program studimi, në kuadër të përdorimit të programeve kompjuterike në përpunimin e të dhënave për lëndë të kërkimit shkencor.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Vërehet se institucioni ka kapacitetet e nevojshme për të mundësuar zhvillimin e praktikave dhe veprimtarive të tjera. Kështu, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës mundësohet lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe organizata të ndryshme, në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në

Nga vizita në institucion konstatohet se institucioni vë në dispozicion për studentët bibliotekën, e cila qëndron hapur nga e

mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	hëna në të shtunë në oraret 09.00 - 20.00 dhe në periudhën e sezonit ky orar është edhe më gjatë.			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi listën e kopjeve fizike të librave në fushën e psikologjisë, e vila iu vë në dispozicion dhe rezultoi se janë 207 tituj të renditur, por nga një shqyrtim i titujve shihen edhe libra që nuk i përkasin kësaj fushe apo nuk janë libra që mund të përdoren në kontekstin akademik (p.sh., “Përse të tjerë duam dhe me të tjerë martohemi”, “Dieta?! Jo vetëm”), ndërsa fondi i librave fizik në programin e studimit shihet të jetë i kufizuar. Sugjerohet një përzgjedhje më e kujdesshme e titujve të librave të përshtatshëm për kontekstin akademik dhe po ashtu të lidhur me këtë .			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion u konfirmua se institucioni ka siguruar akses për studentët që ndjekin këtë program studimi në bibliotekat online si Sage, Ebasco dhe Questia kundrejt asnjë detyrimi financiar.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në takimin me përgjegjësen e bibliotekës së institucionit, GVJ iu komunikua se në kompjuterat që ndodhen në bibliotekë, studentët kanë mundësi të aksesojnë bibliotekat online. Premtuese për veprimtarinë akademike dhe kërkimore shihet edhe fakti që biblioteka e institucionit është pjesë e sistemit COBISS.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet se institucioni bën përpjekje të pasurojë bibliotekën dhe ka vendosur një procedurë sesi të bëhet pasurimi i saj (referenca e formularit për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Konstatohet se biblioteka është në dispozicion të studentëve, e përputhur me oraret që zhvillohen veprimtaritë akademike të këtij programi studimi. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera, dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti Wireless.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të DVV, si dhe në takimet në institucion, vërtetohet se institucioni disponon një sistem të


<p>cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët, i cili emërtohet UMIS. Në dokumentin “Manuali i përdoruesit të UMIS” shihet se në këtë sistem përfshihen informacione të tilla si informacionin personal të studentit, rezultatet akademike, etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Konstatohet se sistemi i brendshëm i menaxhimit mundëson ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Në DVV dhe as në RVB nuk duket e qartë nëse në këtë sistem ndodhet informacion dhe dokumentacion për personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se në sistemin e menaxhimit të të mësuarit (LMS) personeli akademik dhe studentët kanë akses të dedikuar në informacionet që lidhen me procesin mësimor që përfshin kursin dhe lëndët që ata ndjekin dhe angazhohen.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vërehet se sistemi që disponon institucioni mundëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, literaturën, etj.) mes pedagogut dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi LMS është një platformë online që mundëson monitorim për mbarëvajtjen e procesit të akademik, si mundëson gjenerim me të dhëna statistikore. Po ashtu prodhimin e raporteve statistikore për funksionimin e institucionit, si financat, e mundëson dhe sistemi UMIS.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të internetit (www.uet.edu.al) që institucioni disponon, vihet re se programi i studimit është listuar korrekt por nuk ka informacione mbi kurrikulën i këtij programi. Po ashtu jepen informacione për stafin akademik të angazhuar në njësinë bazë (nuk është përditësuar) si dhe prezantohet aktivitetet e ndërmarra nga institucioni. Këto informacione janë të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.6



Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takim me zyrën e financës konstatohet se institucioni harton raporte financiare, të cilat përmbajnë të ardhurat dhe shpenzimet, por dhe përcaktimin e rezervave të nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet për vijimësinë. Theksojmë se këto raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Vërehet se nuk ka plan financimi për programet e studimit, ai hartohet në nivel institucioni nga Asambleja ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura, por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Asambleja në komunikim me departamentet vendos për caktimin e tarifës së shkollimit. Planifikimi dhe shpenzimet buxhetore bëhen në rang universiteti. Për sa i përket burimeve të të ardhurave pjesa më e madhe vjen nga tarifat e studentëve, por institucioni ka edhe të ardhura dytësore nga projekte, lëshimi i ambjenteve me qera, nga vërtetimet e studentëve, donacionet e ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Mbështetur në RVB por edhe gjatë takimit me zyrën e financës me përgjegjësen e të cilës GVJ bisedoi rreth burimeve financiare, GVJ shprehet se: Institucioni kryen audit të përvitshëm për situatën financiare. Raporti i auditit përmban pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet; theksojmë se vitet e fundit 2013-2018 është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku institucioni është pjesëmarrës.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Konstatohet se institucioni dokumenton raportet financiare dhe bën planifikimet e nevojshme për të mundësuar mbarëvajtjen e programeve të studimit në vijimësi. Gjatë vizitës në institucion nga zyra e financës na u paraqit procedura që ndjek institucioni. Ai përmes departamentit studion tregun e punës (Ref. 17), nëse ka pritshmëri për të ardhme dhe bën një plan biznes. Nëse pritshmëritë janë të larta atëherë programi i studimit mbështetet financiarisht.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka</p>	<p>Në takimin me zyrën e financës, GVJ iu bë e ditur se të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.</p>



kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë.	Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1) përcakton kriteret e aplikimit të cilat publikohen edhe online dhe pastaj institucioni ka politika të paracaktuara që mbulojnë ciklin e plotë akademik. Kriteret për aplikim janë të shpallura edhe në ueb faqen e universitetit.			
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullore UET, neni 42 (ref.Nr.5) garanton barazi dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët në universitet përfshirë edhe programin vlerësues.			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në raportin e vetëvlerësimit dhe në dokumentet e dorëzuara janë një sërë dokumentesh që qartësojnë procedurat e pranimit e përzgjedhjes, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të cilat janë të qasshme me kërkesë por edhe në intranetin e UET.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Institucioni në bazë të kapaciteteve infrastrukturore që ka, çdo vit cakton numrin e studentëve që do të pranohen. Për çdo vit cakton numrin e kandidatëve që mund të pranojë programi.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni çdo vit organizon fushatë mediatike për programet në dispozicion. Po ashtu në hollin e UET ofron edhe këshillim të drejtpërdrejtë me kandidatë potencial për kushtet e studimit dhe informatë për programin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se programi dhe institucioni përmes platformave online i informon studentët në meny të vazhdueshme për vlerësimet që kanë të bëjnë me programin.			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Dokumenti i dorëzuar Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28) përcakton kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të tjera.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo semestri studentët pranojnë syllabuses në të cilat përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka dokument i cili mund të përdoret nga studentët për të punuar punimin e diplomës. Dokumenti është i strukturuar dhe i kuptueshëm.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Sipas raportimit të vlerësimit të brendshëm UET zhvillon Javën e Orientimit qëllimi është informimi i studentëve të rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambientit dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Po ashtu gjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Këto bëhen me takime të drejtpërdrejte në mes stafit të UET dhe studentëve të interesuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informatat për programin studentët i pranojnë para regjistrimit, ju ofrohen rregulloret e studimit dhe në momentin kur e nënshkruajnë kontratën e regjistrimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Mund të konstatohet se institucioni përmes sistemit online LMS ju vendos në dispozicion studentëve të gjitha dokumentet e nevojshme për studime dhe përfundim të programit. Studentët që nga fillimi i semestrit për çdo lëndë janë të informuar për ngarkesat, temat javore, vlerësimin, literaturën etj.

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka zyrën për këshillim të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit (Ref. 12). Institucioni ka borde të tregut të punës që tentojnë të krijojnë një urë lidhëse në mes të tregut dhe universitetit. Nuk është e qartë nga dokumentacioni se sa është përqindja e punësimeve përmes këtyre mekanizmave. Institucioni organizon panairë të punësimit dhe përmes njoftimeve të ndryshme për mundësi të punësimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka në dispozicion mekanizmat e duhura për të përditësuar kandidatët me ndryshimet eventuale në program qoftë përmes informimeve klasike apo online.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>I gjithë stafi dhe studentët janë të pajisur me e-mail zyrtarë përmes të cilave mund të njoftohen për të gjitha informatat apo kumtimet e nevojshme.</p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Zyra e regjistrimit të studentëve ka të gjitha informatat, dokumentet dhe shënimet për aktivitetin mësimor të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka të gjitha statistikat për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit (Ref. 29).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Institucioni ka të gjitha statistikat vjetore për studentët të regjistruar në sistemin elektronik UMIS. Nga ky sistem mund të gjenerohen statistika të tjera sipas nevojës. Institucioni disponon me statistika që shkallën e punësimit, kalueshmërinë, transferimet etj.</p>

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni posedon dokumentim fizik dhe atë elektronik për gjithë veprimtarinë e studentëve nga regjistrimi deri diplomim. Të dhënat ruhen në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve. Dokumenti <i>Ref. Nr. 9</i> përshkruan funksionimin e sekretarisë mësimore.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është sistemi kryesor përmes të cilës të dhënat ruhen dhe janë të sigurta dhe menaxhimi i sistemit bëhet përmes zyrës së IT-së ku caktohen rregullat e qasjes së studentëve dhe stafit në informatat që mund të vijnë nga UMIS.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Dokumenti <i>Ref. Nr. 38</i> është një raport përmbledhës për departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve. Raporti mund të përmbajë informata shitesë shembull nga vlerësimet e rregullta të studentëve dhe kërkesat e tyre për përmirësime eventuale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Dokumenti <i>Ref. Nr. 2</i> me nenet specifike në dokument cakton përfaqësimin e studentëve në struktura të ndryshme të institucionit. Strukturat kryesore të përmendura në dokumentin vlerësues janë: <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj është e hapur për studentët.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Komisioni vlerësues konstaton se institucioni ka të rregulluar pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe procese të tjera qoftë përmes pjesëmarrjes në takime, studimet me fokus grupe dhe vlerësimet e rregullta online të cilat studentët i bëjnë për lëndët që i kanë marrë. GVB i programit të psikologjisë përfshin edhe një student të programit të masterit që vlerësohet.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të	Komisioni vlerësues konstaton se numri i kredive dhe ngarkesa e studentëve për lëndë të caktuara është në përputhje me shumicën e

<p>mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>programeve të tjera te programit master. Po ashtu programi ka një logjikë të caktuar për shpërndarjen e lëndëve përgjatë semestrave ku studentët në vitin e parë kanë më shumë lëndë dhe në vitin e dytë kanë nga një lëndë në semestër dhe punojnë në temën dhe punë praktike.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Komisioni konstaton se institucioni i ka mekanizmat e duhura ligjore dhe praktike për përfshirjen dhe marrjen e mendimit të studentëve në lidhje me programin aktual që vlerësohet.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Institucioni i vlerësuar ka mekanizma të duhura për mundësinë e ankimimit të rezultateve të vlerësimit apo për ndonjë çështje tjetër. Këto procese janë të rregulluara me dokumente të brendshme (Ref. Nr. 5.; Ref. Nr. 40.1).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV konstatohet se personeli akademik i njesisë që ofron këtë program studimi ka publikuar artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse (Ref 43). Megjithatë rekomandohet që stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi duhet të intensifikoje përpjekjet për të botuar artikuj shkencorë në revistat shkencore të indeksuara, si dhe të përfshihet më shumë në projekte kërkimore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Komisioni vlerësues konstaton se përkundër tentativave të përmendura për marrëveshje (Ref. Nr. 34) partneriteti me institucione të huaja, ato mbesin te pakta në posaçërisht në programin e vlerësuar. Institucioni nuk ka ndonjë projekt hulumtues që përfshin stafin apo studentët e departamentit.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë,</p>	<p>Komisioni konstaton se ka disa shembuj pozitiv të përfshirjes së studentëve në studimet që kanë një sinergji të bashkëveprimit për të</p>

shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	arritur një qëllim të madh. Komisioni vlerësues rekomandon që institucioni të hartojë projekte studiuuese që do të angazhonin studentët e masterit në grumbullim të dhënave në një temë të gjerë që është në interes të institucionit apo publikut. Shembulli i studimit me bullizmin duhet të jetë një strategji që mund të zbatohet në të ardhmen.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Gjatë vizitës vlerësuese disa herë është përmendur fondi i veçantë, prej 75.000 eurosh, për të nxitur stafin, për të kryer një punë kërkimore shkencore dhe të botojnë në revista me imakt faktorë që është hap për tu përshëndetur. Komisioni konstaton se përkundër kësaj iniciative institucioni nuk ka mekanizma për të përkrahur studimet që mund të vijnë nga stafi akademik apo nga studentët. Përvojat nga vendet në zhvillim tregojnë se publikimi në revista me faktor impakti zakonisht shoqërohet me financim paraprak të studimeve.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Komisioni konstaton se personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studimet inovative por pa ndonjë strukturë apo mekanizëm që është në formë projekti të vazhdueshëm që është praktikë e shpeshtë në universitete apo programe në vende të tjera.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Institucioni përmes personelit akademik ofron asistencë të nevojshme për kryerjen e analizave dhe matjeve të ndryshme që studentët mund t'i kenë bërë për punim diplome.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Në dokumentin e vlerësimit të brendshëm grupi vlerësues cek marrëveshjet ndërkombëtare gjersa kriteri duket që është për institucionet kombëtare.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Komisioni vlerësues konstaton se lëndët ekzistuese me fokus në metodat e hulumtimit dhe punimi i temës së diplomës si studim (kualitativ apo kuantitativ) në një formë i përgatit kandidatët për ciklin e tretë të studimeve. Po ashtu në secilën lëndë nga studentët kërkohet të dorëzojnë punime që kërkojnë shqyrtim literature gjë që konsiderohet të ndihmojë në përgatitjen e kandidatëve për studime në ciklin e tretë.

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>UET ka një mekanizëm të përfshirjes së studiuesëve të rinj në projekte e mëdha kërkimore të cilat udhëhiqen nga ekspertët më me përvojë në universitet. Komisioni vlerësues konstaton se programi i studimit duhet të ketë më shumë projekte hulumtuese pasi ofron diplomë me fokus në një fushë të caktuar të psikologjisë. PMK mund të fokusohen në disiplinat për të cilat ofron sub-specializimet.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni nuk ka grante apo projekte ndërkombëtare që do të mundësonte bashkëpunimin me ekspertë ndërkombëtarë. Po ashtu institucioni ose programi i vlerësuar nuk ka ndonjë politikë që përcakton përfshirjen e rregullt të kërkuesve të huaj shkencor.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni synon ndërkombëtarizimin e vet dhe mobiliteti i studenteve të këtij programi përmes programit Erasmus + është një përpjekje pozitive. Nuk konstatohet ndonjë politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve në veprimtari ndërkombëtare.</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fiton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk ka dëshmi të përfshirjes së personelit akademik ndërkombëtar në kuadër të programit ekzistues të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		


Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të IAL-ve.</p>	<p>Dokumenti ref. Nr. 12 përcakton rregullat e funksionimit të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, dhe kjo zyre duket të jetë zyre kryesore që e plotëson këtë kriter. Po ashtu secili departamenti sipas raportit të vetëvlerësimit ka këshillim akademik dhe metodologjik, e cila është përcaktuar dhe përmendur në dokumentin Ref. Nr. 27.2.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përpos sistemeve të këshillimit të përmendur në kriterin 1 nuk ka ndonjë sistem tjetër që ofron këshillim, ndjekje të përparimit të studentëve dhe asistimin me programin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>Sipas raportit vetëvlerësues Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ofron këshillim gjatë gjithë kohës studentëve nga regjistrimi deri në diplomim por me gjasë me kërkesën e studentit.</p>

<p>informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Shërbim tjetër konsiderohen edhe këshillimet me stafin akademik gjatë orareve të konsultimeve.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Komisioni konstaton se institucioni ka të dhëna për shkallën e punësimit që janë të dokumentuar në <i>Ref. Nr. 29</i>, të cilat janë edhe publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE


Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatorë institucionale.	Konstatohet se ka nene specifike në Statutin e UET dhe në rregullore të ndryshme të institucionit përfshirë edhe dokumentin e ndarë që rregullon kontrollin e cilësisë brenda institucionit. Komisioni vlerësues konsideron se institucioni ka politika të qarta për monitorim të cilësisë.			
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Dokumentet e dorëzuara <i>Ref. Nr. 30, 30.1, 30.2, 30.3 dhe 30.4</i> janë dokumentet relevante që rregullojnë dhe udhëzojnë rregullimin e SBSC përmes KSBC. Kjo është e rregulluar në nivel të institucionit dhe departamentet dhe bordet e tregut të punës supozohet të jenë informues të ndryshimeve eventuale që mund të vijnë në programin ekzistues. Në aplikimin nuk vërehet apo nuk është dorëzuar ndonjë ndryshim në programin që vlerësohet si rezultat i këtyre mekanizmave.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Komisioni vlerësues konstaton se institucioni dhe programi në vlerësim ka kaluar nëpër procesin e vlerësimit të jashtëm herën e fundit në vitin 2014. Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat që lidhen me këtë proces.			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	KSBC ka një dokument strategjik 2 vjeçar që përcakton drejtimin dhe planin të përvitshëm ku përcaktohen monitorime të caktuara pas të cilave njoftohen drejtimet përkatëse. Sipas njoftimeve, njësitë e caktuara akademike marrin masa të nevojshme nëse diçka duhet përmirësuar në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Siç është cekur kriterin 2 standardi VI.1 vlerëson se institucioni ka një trup që bën vlerësimin e të gjitha programeve përfshirë edhe atë të ciklit të dytë. Institucioni nuk ka njësi të veçantë për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.			
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm UET dorëzon raporte në formë të vlerësimit që ju vihet në dispozicion njësive akademike dhe pedagogëve. Raporti diskutohet në nivel të rektoratit dhe strukturave të tjera drejtuese. Megjithatë nuk ka mekanizëm të veçantë për mbikëqyrjen në programit të studimit të ciklit të dytë.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Mekanizmi më konkret vlerësues që përmban raporti vlerësues i brendshëm janë vlerësimet që studentët i bëjnë lëndëve pas përfundimit të semestrit. Mësimdhënësit dhe nevojat e tyre nuk është se janë të përfshirë në ndonjë vlerësim sistematik.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Për këtë kriter raporti përmend <i>Ref. Nr.37</i> monitorimin e syllabuseve si vlerësim, por nuk konstatohet ndonjë procedurë për dokumentimin e tyre.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Komisioni vlerësues nuk është se ka pasur qasje në raporte të vlerësimit përpos raporteve të vlerësimit të studentëve për stafin akademik që janë të ruajtur në dosjen e stafit. Pra, konstatohet se ka kufizime në dokumentacionin për të reflektuar mbi raportin e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë	Siç është cekur disa herë në kriteret e standardit VI. 2 nuk ka mekanizmat të veçantë që vlerësojnë programet specifike por KSBC është institucion në nivelin qendror të institucionit. Grupi i vlerësimit të brendshëm është trup që ngrihet në baza të rregullta për qëllim të

<p>informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>përpilimit të raportit të brendshëm të vlerësimit të programit përkatës që akreditohet.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Mekanizmi i vetëm më konkret që zbatohet në baza të rregullta që ka institucioni është vlerësimi që studentët i bëjnë lëndëve të cilat i marrin gjatë semestrit. Instrumente të tjera për komisionin janë përcjellja e nivelit të punësimit dhe fokus grupet e rregullta me studentët.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Duke u bazuar në shqyrtimin e dokumenteve, bisedave me student programi përdor, teste paraprake dhe përfundimtarë, punime, praktikë, vlerësim të punimeve. Komisioni vlerësues nuk e ka të qartë se çfarë teste të standardizuara përdoren dhe që janë të përmendur në raportin e vlerësimit. Përpos mekanizmave vlerësues të përmendur më sipër që vlejné për studentë, stafi më i ri akademik vëzhgohen nga eprorët apo nga drejtuesi i departamentit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Format e vlerësimit të strukturuar janë: vlerësimi i strukturuar i studentëve për mbarëvajtjen e lëndëve; fokus grupet që përdoren me studentë. Nuk ka vlerësime të ngjashme që mund të bëjnë vlerësimin e kënaqësisë dhe nevojave specifike të stafit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dy projekte relevante që janë në nivelin institucional projektet TEMPUS 'ENCHASE' dhe Erasmus+ QAINAL pasi këto projekte janë konkrete dhe ndërlidhen me rritjen e cilësisë duke përcjellë përvoja nga vende të tjera. Përfshirja e aktorëve të brendshëm është sqaruar në vlerësimin e standardeve VI.2 dhe VI.3.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni ka dokumente relevante ligjore specifike që kanë të bëjnë me cilësinë dhe nene që lidhen me cilësinë dhe përgjegjësitë e institucioneve në këtë proces.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Programet përfaqësohen në KSBC përmes një pedagogu të çdo fakulteti e jo programi specifik. Pra nuk ka përfshirje specifike të programit në këshilla apo trupa të tjerë që bëjnë vlerësimin e cilësisë në institucion.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm përmenden 5 kritere në përzgjedhjen e individëve në këto komisione ose trupa: Kompetencat profesionale; Paanshmëria; Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. Këto tipare sigurojnë objektivitet dhe një përfaqësim që e ruan personin nga konflikti i interesit.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Programi i studimit nuk ka përfshirje të ekspertit të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së brendshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga raporti i vlerësimit nuk është e qartë nëse raportet e monitorimit të cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nuk ka dëshmi nëse institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimit të cilësisë së brendshme.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në dokumentet e dorëzuara nuk ka ndonjë situatë konkrete kur rezultatet e vlerësimit kanë rezultuar me marrje masash konkrete në kuadër të programit të vlerësuar. Në raportin e vlerësimit përmenden trajnime didaktike për stafin që nuk lidhet drejtpërdrejtë me stafin e programit që vlerësohet.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Komisioni vlerësues konstaton se institucioni ka mekanizma të vlerësimit që janë të përqendruar me shumë në nivelin institucional dhe se ato mund të mos jenë aq të ndjeshme për të kuptuar nevojat për ndryshime në nivelin e programeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Janë disa mekanizma si takimet e rregullta në kuadër të institucioneve si KSBC, Senati, këshillimi i studentëve që mund të konsiderohen si mundësi për diskutim të cilësisë por jo domosdomërisht që lidhen në formë eksplicite me përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile: a. Psikologji klinike, b. Psikologji shkollore, c. Psikologji keshillimi, d. Psikologji organizacionale, e. Menaxhim dhe vlerësim projektesh, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europin i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. IAL dhe njësia bazë që ofron këtë program studimi demonstroi përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me kërkesat e tregut të punës përmes marrëdhënieve të konsoliduara me UET ALUMNI të punësuar, bordit të tregut të punës dhe palë të tjera të interesuara.
2. Njësia bazë e ofrimit të masterit bën rishikimin e syllabuseve me inputin e dhënë nga pedagogët e lëndës dhe anëtarët e bordit të tregut të punës.
3. Institucioni ka konsoliduar mekanizma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe vlerësimit të pedagogëve prej tyre.
4. Dixhtalizimi i sistemit të të dhënave në ndihmë të infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie, ku stafi akademik dhe studentët kanë hapësirën e tyre personale në këtë sistem elektronik për hulumtime të mëtejshme akademike dhe jo vetëm.
5. Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë për sa i përket gjithë procesi që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit.
6. Infrastruktura fizike është e përshtatshme dhe në funksion të realizimit të procesit mësimor.
7. Abonimi në bibliotekën online EBSCO & SAGE dhe COBISS Net dhe aksesin e studentëve dhe stafit akademik ndihmojnë procesin akademik.
8. Vëmendja institucionale për të evituar plagjaturën duke përdorur prej gati 5 vitesh edhe programin softverik për antiplagjaturë.
9. Krijimi i një fondi në nivel institucioni që jepet në formën e shpërblimit për stafin akademik që realizojnë kërkime shkencore dhe publikojnë në revistat shkencore me faktor impakti shihet si një mundësi e mirë për të nxitur prodhimtarinë shkencore.

Pika të dobëta

1. Ndryshimet e shpeshta të stafit akademik, të cilat vënë në rrezik qëndrueshmërinë e programit.
2. Konstatohet se fusha akademike-kërkimore e një pjesë të personelit akademik të mos jetë në përputhje me programin e studimit.
3. Pavarësisht se kurrikula e këtij programi studimi mundëson zhvillimin e njohurive dhe aftësive, është e domosdoshme që ajo të përmirësohet, pasi lëndët që përbëjnë profilet janë shumë të

kufizuara për të mundësuar thellimin e studenteve në profilin që ata përzgjedhin. Diferenca prej tre lëndësh në secilin profil mund të rrisojë përgatitjen e tyre për të qenë konkurrues në tregun e punës.

4. Studimi i tregut të punës rezulton të jetë pjesërisht empirik, dhe mbetet i pjesshëm duke qenë se nuk prezanton nevojat për secilin profil me të njëjtën peshë. Ai duhet të ndërtohet mbi instrumente të studimit real. Pamundësia për të përshtatur riorganizimin e programit me nevojat e tregut të punës e bën të vështirë në këtë moment aplikimin e mëtejshëm të punësimit të studentëve në treg.
5. Marrëveshjet e praktikës për këtë program masteri vlerësohen të mos jenë të të njëjtës shkallë cilësie për secilin profil (sidomos profili organizacional, menaxhim dhe vlerësim projektesh).
6. Edhe pse janë organizuar disa trajnime profesionale nga institucioni për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, temat e trajnimeve nuk kanë qenë përfshirëse për të gjithë profilet që ky program ofron.
7. Ka mungesë edhe të projekteve hulumtuese që kanë natyrë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe që mund të organizohen dhe realizohen nga burimet ekzistuese të departamentit. Temat ose fushat mund të jenë në interes të stafit apo edhe të publikut në tërësi.
8. Literatura e cunguar në gjuhën shqipe dhe të huaj për mbulimin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit sipas 5 profileve.


Rekomandime

1. Edhe pse konstatohet se përgjithësisht fusha akademike- kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, në disa përjashtime rekomandohet një vlerësim i kujdesshëm në këtë drejtim si dhe në ndarjen e ngarkesave mësimore këtij stafi.
2. Rekomandohet që në syllabuset e lëndëve (ku është e aplikueshme) të parashikohen detyra praktike (aplikime në terren) me qëllim konkretizimin e njohurive dhe aftësimin e studentëve në kontekstin e profilit të zgjedhur prej tyre.
3. Rekomandohet që të rishikohet edhe njëherë kurrikula me qëllim avancimin e njohurive që studentët do të përfitojnë nga ky program. Më konkretisht sugjerohet që syllabusi i lëndës “Metodat e kërkimit sasior” të rishikohet, për ta bërë më të përthyeshëm në kontekstin e psikologjisë dhe për t’i dhënë një peshë aftësimin për të dizajnuar studime shkencore sasimore.
4. Rekomandohet që departamenti dhe personeli akademik të përshtatë qasjen proaktive duke ndihmuar studentët e këtij programi të ideojnë studime në grup, edhe në kuadër të lëndëve mësimore, si p.sh., lëndët e kërkimit shkencor.
5. Rekomandohet shtimi i marrëveshje me institucione të tjera (si p.sh. institute kërkimi), që do të ndihmonin studentët e pesë profileve të këtij masteri të njihen dhe angazhohen në profilin e përzgjedhur.
6. Rekomandohet që programi ekzistues të analizohet nga prizma dhe rekomandimet e dokumentit të Federatës Europiane të Psikologjisë për certifikim në psikologji e cila synon të unifikojë

certifikimin e psikologëve në Bashkësinë Europiane. Sipas analizës të shikohen mundësitë e përshtatjes së programit sipas mundësive që ka departamenti. Referencë mund të jetë Dokumenti i Federatës Europiane të Psikologjisë për certifikim në psikologji¹.

7. Shtim i bibliotekës me libra (fizik) sipas profileve të programit të studimit.
8. Rekomandohet edhe përfshirje të eksperteve të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së brendshme të këtij programi.
9. Rekomandohet përfshirja e studentëve të këtij masteri në veprimtarinë kërkimore shkencore të departamentit, fakultetit dhe universitetit.

¹<https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=2ahUKEwiKgZ24mvLmAhVF2aQKHWTPAB4QFjAAegQIAxAC&url=http%3A%2F%2Fwww.efpa.eu%2Fdownload%2Faa50b2aa4be51a2778d746f8aa583f1a&usg=AOvVaw0IYxKLBbKjzb-LNeBEoWHk>



Conclusions of the evaluation of second cycle study program “Master of Science in Psychology”, with profiles: a. Clinical Psychology, b. School Psychology, c. Organizational Psychology, d. Counseling Psychology, e. Management and Project evaluation in “European University of Tirana”.

Strengths and affirmations

1. UET and the core unit that offers this study program demonstrate ongoing efforts to keep in touch with labor market demands through consolidated relationships with employed students UET ALUMNI, labor market board and other stakeholders.
2. The department reviews syllabuses with the input provided by lecturers and members the labor market board.
3. Institution has consolidated some mechanisms of involving students in periodic evaluation of teaching methods, knowledge assessment and lecturer performance evaluation.
4. Digitalization of the data system support of the teaching and learning infrastructure and the academic staff and students have their own space in this electronic system for further academic research and not only/beyond.
5. The institution has a proper procedure in place for the whole process of examining, evaluating, announcing results and appealing by the student.
6. Institution’s infrastructure is suitable for the learning process.
7. Subscription to EBSCO & SAGE and COBISS Net online library support the academic process.
8. The institution has paid special attention to avoid pagiarism by implementing anti-plagiarism software program for almost 5 years.
9. The fund that is given as reward for academic staff conducting research and publishing in peer-reviewed journals is considered a good opportunity to engourage qualitative scientific papers.


Weaknesses

1. Frequent changes of academic staff, which endanger the stability of the program.
2. It is found that the academic research field for some academic staff is not in accordance with the study program.
3. Although the curriculum of this study program enables the development of knowledge and skills, it is necessary to improve it further, as the subjects that make up the profile’s differentiation are very limited and cannot enable students to deepen their knowledge in the profile they select. The difference of three subjects in each of the profiles may risk their career preparation and their competition in the labor market.

4. Labor market study turns out to be partially empirical and it remains partial as it does not present the needs for each profile with the same weight. It is needed that this research to be built on real survey instruments. The inability to adapt the program reorganization to the needs of the labor market makes it difficult at this time, student's employment in the market.
5. The internship arrangements for this master program are assessed to be not of the same quality degree for each profile (especially organizational profile, management and project evaluation).
6. Although some vocational training has been organized by the institution for graduated students in coordination with foreign employers, training topics have not been all inclusive for all the profiles that this program offers.
7. There is also lack of large research projects that can be organized and implemented from existing departmental resources. Topics or areas may be in the interest of staff or even the public.
8. Limited literature in Albanian and foreign language to cover the study program subjects and modules according to 5 profiles.

Reccomandations

1. Although it is found that the academic-research area of the academic staff is generally in line with the study program, there are some exceptions. It is recommended a careful consideration in this regard as well as the allocation of teaching loads to this staff.
2. It is recommended that inside the subject syllabuses (where applicable) to be provide practical assignments (field applications) in order to concretize knowledge and to train students in the context of their chosen profile.
3. It is recommended the revision of the curriculum in order to advance the knowledge that students will benefit from this program. More specifically, it is suggested that the syllabus of the subject "Quantitative Research Methods" need to be revised, to make it more translatabe in the context of psychology and to give a weight to the ability to design quantitative scientific studies.
4. It is recommended that the department and academic staff to adopt a proactive approach by helping students in this program to design studies as a team, even within teaching subjects such as research subjects.
5. It is recommended to increase the number of agreements with other institutions (such as research institutes) that would help students of the five profiles of this master to be recognized and engaged in the selected profile.
6. It is recommended that the existing program to be analyzed based on recommendations of the European Federation of Psychology document on certification in psychology which aims to unify the certification of psychologists in the European Union. According to the analysis, it is needed to



see the possibility for adjusting the program within this framework. Reference may be to the Document of the European Federation of Psychology for certification in psychology².

7. Increase of hardcopy books according to study program profiles.
8. It is also recommended to involve external experts in the evaluation of the internal quality report of this master program
9. It is recommended to involve students of this master program in the research activity of the department, faculty and university.

²<https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=2ahUKEwiKgZ24mvLmAhVF2aQKHWTPAB4QFjAAegQIAxAC&url=http%3A%2F%2Fwww.efpa.eu%2Fdownload%2Faa50b2aa4be51a2778d746f8aa583f1a&usg=AOvVaw0IYxKLBbKjzb-LNeBEoWHk>

